



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 21.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Professional Alarm" për aktivitetin: "Furnizimi dhe montimi i paisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6729-111 nxjerr:

VENDIM

APROVOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Professional Alarm" e datës 18.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi i paisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6729-111 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 13.05.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Anulohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 13.05.2020 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin sipas te njejt;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Profesional Alarm" me datë 18.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi i paisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6729-111.

Autoriteti Kontraktues, me datë 21.05.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet nga pikat 1,2,3 dhe 5 të Kërkeses tuaj janë të bazuara, pasi që tenderusei i propozuar për dhenje të kontratës nuk ka ofruar katalogje që deshmojnë gajtesinë e kabllit ndërmjet lexuesit dhe kontrollit dhe katalog për kontrollin e derës, ndërsa nga katalogjet e

ofruara per pozicionin 3.1.3 dhe 3.1.9 shihet se te njejtat nuk plotesojne kerkesat teknike te Autoritetit Kontraktues.

Bazuar ne gjendjen faktike te verifikuar nga deshmita e dorezuara me tenderin e tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates konstatoj se pretendimet tuaja jane krysisht te bazuara dhe rekomandoj qe aktiviteti te kthehet ne rivleresim.

Kerkoj qe ne fazen e rivlersimit te propozohen anetar profesionist ne komision ne menyre qe vleresimi i tendereve te jete korekt.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

